



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.83/2016

Prishtinë, më 27.12.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Raif Qela, Sala Berisha- Shala, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

I ftuar: Avdullah Hoti, ministër i Ministrisë së Financave.

Pjesëmarrës të tjerë: Qemajl Marmullakaj, Adnan Ahmeti– ZKM, Astrit Hoti, Artë Kastrati dhe Fatos –LokajMF, Eugen Cakolli – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Etleva Malushaj – LVV, dhe Bujar Tresi– RTV21.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.12.2016;
- 3.Diskutim rreth Programit të Kosovës për Reforma Ekonomike 2017-2019;
- 4.Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Raif Qela propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe më dy pika tjera, si: Rekomandimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit të Postës së Kosovës me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Komunat, si dhe ecurinë e zbatimit të Ligjit për Trepçën, kurse ky diskutim të behët më dyer të mbyllura.

Kryetari theksoi se këto çështje do të diskutohen në të ndryshme, lidhur me mbajtjen e mbledhjes me dyer të mbyllura sipas propozimit, do të behët në pajtim më Rregulloren e Kuvendit.

Rendi i ditës u miratua, me ndryshimin që në pikën e katërt Të ndryshme, të diskutohen çështjet e ngritura nga deputeti Raif Qela.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.12.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 13.12.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim rreth Programit të Kosovës për Reforma Ekonomike 2017-2019

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se materialin për këtë çështje e kemi marrë. Qëllimi i sotëm është që të diskutojmë paraprakisht këtë Program të Reformës Ekonomike para se ta aprovojmë Qeveria dhe ta dërgojmë në Komisionin Evropian. Kryetari fillimisht i dha fjalën Ministrit të Financave Abdullah Hotit, që ta prezantojë Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike.

Abdullah Hoti, ministër i Ministrisë së Financave, tha se kjo është hera e tretë që Qeveria e Kosovës e dorëzon këtë dokument në Komisionin Evropian, i cili ka për qëllim të identifikojë masat njëvjeçare brenda një viti. Pra, nuk është një dokument gjithëpërfshirës, por është një dokument, një listë e masave specifike që duhet të ndërmerren nga Qeveria e vendit për të adresuar kufizimet në rritje ekonomike, kufizime këto, që janë identifikuar nëpër dokumente të ndryshme strategjike që ka vendi, duke filluar nga strategjia kombëtare për zhvillim, strategjitë sektoriale dhe dokumente tjera në bazë të të cilave ne i bazojmë planet tona njëvjeçare dhe dyvjeçare. Në qershor të këtij viti, Komisioni Evropian ka lëshuar udhëzimet në bazë të të cilave ne kemi përgatitur draftin e këtij dokumenti, mandej në korrik Qeveria e Kosovës në bazë të udhëzimeve të Komisionit Evropian e ka themeluar ekipin i cili e ka punuar draftin e këtij programi, të cilin e kryesojmë ne si koordinatorë, bashkë me Zyrën për Planifikim Strategjikë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Janë zhvilluar diskutime detale me të gjitha ministrinë, ku janë marr pikat nga këto strategji sektoriale që i përmenda më herët. Ne në parim i kemi aprovuar në Këshillin, Komisionin për Planifikim Strategjik në kuadër të Qeverisë që kryesohet nga kryeministri, ku marrin pjesë disa ministra të sektorëve kyç të fushave të ekonomisë, bujqësisë, ambientit dhe disa sektorë të tjerë dhe tani qëllimi jonë është që ta ndajmë këtë dokument me komisionet përkatëse të Parlamentit, me shoqërinë civile, me bizneset përmes odave ekonomike, në mënyrë që t'i marrim inputet nga të gjitha palët e interesit përpara se ta finalizojmë këtë dokument në pjesën e parë të janarit dhe ta aprovojmë në Qeveri dhe pastaj kemi një afat kohor deri në fund të janarit, kur duhet ta dorëzojmë në Komisionin Evropian.

Pastaj, kemi procedurë brenda Komisionit Evropian. Ky dokument përdoret për të monitoruar progresin në reforma të ndryshme në Kosovë gjatë gjithë vitit, përpara se të bëhet Raporti i Progresit në vjeshtë të këtij viti siç është traditë në Komisionin Evropian. Pra, për qartësim të deputetëve, kjo nuk është një listë gjithëpërfshirëse e masave, por një listë e targetuar, e kufizuar e masave specifike që i adresojnë disa prej problemeve të zhvillimit ekonomik në vend. Ne i kemi identifikuar nëntë fusha. Unë po i përmend vetëm fushat që jemi dakorduar në nivel të qeverisjes, të cilat do të jenë në fushën e menaxhimit të financave publike, është një masë specifike përveç masave tjera, në fushën e energjisë, infrastrukturë dhe telekomunikacion, janë një numër i masave, në bujqësi, industri dhe shërbime, janë pesë masa specifike, në fushën e mjedisit për biznes dhe uljen e ekonomisë informale, kemi tek inovacionet dhe hulumtimet në veçanti ngritja e kapacitetit të burimeve njerëzore për tregun e punës, në tregtinë e jashtme lehtësimi i tregtisë, përmirësimi infrastrukturës së cilësisë, tek arsimit dhe shkathhtësia është krijimi i sistemit që lidh sistemin e arsimit me tregun e punës, tek punësimi dhe tregu i punës në veçanti është funksionalizimi i plotë i agjencisë së punësimit dhe masave të tregut të punës, dhe tek fusha e çështjeve sociale dhe uljes së varfërisë, është një masë specifike që ka të bëjë me përmirësimin e përgjithshëm të zhvillimeve sociale dhe atyre shëndetësore. Në masë të madhe ne jemi munduar që të gjitha këto masa ti reflektojmë në buxhetin e vitit 2017, në parim masën që mund të realizohet sa i përket implikimeve buxhetore, pasi të aprovohen këto masa në janar, që edhe do të propozohen, mandej ministritë përkatëse i përgatisin planet për zbatimin e këtyre masave. Ne sot jemi të gatshëm të pranojmë sugjerimet dhe vlerësimet e juaja, inute që mund ti jepni ju përpara se ta finalizojmë këtë dokument.

Qemajl Marmullakaj – ZKM, theksoi se në bazë të udhëzuesit të Komisionit Evropian, janë 20 masa të cilat ne mund t'ia propozojmë dhe t'i dorëzojmë për Komisionin Evropian dhe këto masa janë përzgjedhë në një numër bukur të madh të masave që kanë qenë të propozuara nga ministritë, por që nga filtrimi i tyre është bërë një proces, duke u bazuar në konsultimet me Komisionin Evropian dhe me dokumente strategjike dhe Komisionin për Planifikim, të cilat i kemi përfunduar. Në kuadër të shtyllës së parë të menaxhimit të financave publike masa e përmirësimit, nëpërmjet aplikimit të prokurimit adreson promovimin e përdorimit të gjerë të prokurimit publik elektronik të autoriteteve qendrore dhe lokale përmes një sistemi më adekuat të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Qëllimi i kësaj mase kryesore është rritja e efikasitetit dhe transparencës në prokurimin publik. Tek sektori energjia transporti dhe telekom, kemi tri masa, ku masa e parë është ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efikasitetit. Synim i kësaj mase është arritja në 9% deri në vitin 2018 të kursimit të energjisë nëpërmjet zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtërishme. Pastaj e kemi edhe masën tjetër zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve prodhuese të energjisë ku synim kryesor është siguria e energjisë përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja, siç është “Kosova e Re” dhe rehabilitimi i termocentralit “Kosova B”. Masë tjetër e këtij sektori është shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjeteve të TIK-ut, ku synim kryesor do të jetë gjatë periudhës dyvjeçare, është rritja e infrastrukturës brezëgjërë të TIK-ut në masën 90% të vendit deri në vitin 2021. Zhvillimet sektoriale kanë tri masa të propozuara e të përzgjedhura deri më tani. Në thelb, masa e parë e zhvillimeve sektoriale investimet në infrastrukturën bujqësore dhe agro-përpunimi, ku synohet të adresohen sfidat lidhur me infrastrukturën bujqësore, diversifikimin e produkteve bujqësore, mbulueshmërinë e sistemit të ujitje . Rregullimi dhe konsolidimi i tokave bujqësore synim është konsolidimi vullnetar, ku synohet të arrihet rritja e madhësisë mesatare të fermave një qasje më e lehtë në ngastrat kadastrale dhe shfrytëzimi më

racional në përgjithësi i fermave dhe tokës bujqësore. Masa tjetër për zhvillimet sektoriale është përshtatje me zhvillimin me grupimet industriale. Kjo masë është mjaft e komplikuar si reformë dhe e adreson zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë përmes zhvillimeve grupore të tyre. Zhvillimi i produkteve turistike në rajonet turistike, në rajonet e Kosovës, ku qëllim kryesor është zhvillimi i produkteve turistike duke synuar rritjen e vlerës ekonomike të turizmit. Me këtë synohet të identifikohen produktet vendore dhe ato produkte me potencial rajonal në aspektin e turizmit. Në kuadër të sektorit të mjedisit të të bërit biznes dhe uljes së ekonomisë joformale, janë të identifikuara pesë masa; zhvillimi i politikave bazuar në të dhëna, është masa e parë e këtij sektori, ku qëllim i masës është thjeshtësimi i legjislacionit dhe sistemit rregullativ, duke përfshi edhe vendosjen e qasjes për uljen e ngarkesave administrative burokratike për biznese. Masë e dhjetë është sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin përmes kësaj mase synohet të adresohet informaliteti në sektorin e patundshmërive, në mënyrë që qytetarëve t'u sigurohet qasje në procese administrative efikase dhe financiarisht të përballueshme. Masa e njëmbëdhjetë apo masa e tretë e sektorit të mjedisit të bërit biznes është rritja e efikasitetit të gjyqësorit përmes uljes së rasteve të grumbulluara. Kjo është masë që ndërlidhet në masë të madhe me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe ka qenë një nga masat kyçe të pengesave të zhvillimit ekonomik të vendit dhe synohet që të përmirësohet efikasiteti i gjyqësorit më qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara përmes rritjeve të kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit të rasteve të gjyqësorit. Masë tjetër e mjedisit të bërit biznes është përmirësimi i qasjes në financat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Krijimi i një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave është masa e fundit e mjedisit të të bërit biznes dhe qëllimi i kësaj mase është adresimi i ekonomisë joformale përmes zvogëlimit të hendekut tatimor, përmes strukturave institucionale të thjeshtësuara dhe efektive për mbledhjen e të hyrave. Inovacioni ka një masë, si sektor ka përmirësimin e kornizës së politikave strategjike dhe ngritja e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion. Me këtë masë synohet që Kosova të ketë rritjen e nivelit në pjesëmarrjen e institucioneve shkencore vendore dhe në programet e projekteve evropiane dhe rajonale, pasi që qasja e Kosovës në këto programe është shumë e ulët. Në tregtinë e jashtme dhe lehtësimin e investimeve kemi dy masa; rritja e efikasitetit për kostot e transaksioneve ndërkombëtare tregtare synon të rrit efektivitetin e kostove të transaksioneve të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet thjeshtësimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi, me synim harmonizimin e praktikave në përputhje me marrëveshjet shumëpalëshe dhe praktikat më të mira evropiane dhe është përmirësimi i një infrastrukture të cilësisë e cila adreson modernizimin e infrastrukturës së cilësisë për biznese, si standardizimi i produkteve dhe infrastrukturës ligjore, akreditimit dhe organet për vlerësimet e konformitetit. Arsimit dhe shkathhtësitë, ka dy masa të veçuara, ku harmonizimi i ofertës dhe kërkesës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave synohet të harmonizohen programet e arsimit dhe kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet zhvillimit të shkathhtësive dhe standardeve dhe profesionit, po ashtu me këtë masë synohet të rishikohen edhe kurrikulat. Zbatimi dhe përmirësimi i sistemit të karrierës për mësimdhënësit është masa e dytë e këtij sektori, e objektiv i kësaj mase është zbatimi i sistemit për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve një aspekt, i cili ka qenë i mangët deri më tani përmes skemës së licencimit për avancimin e mësimdhënësve në karrierë dhe zbatimi i kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënies gjatë procesit të ngritjes së kapaciteteve. Tregu i punës dhe punësimi ka vetëm një masë, përmirësimi i shërbimeve të punësimin nëpërmjet krijimit të agjencisë për punësim dhe masave aktive të tregut të punës. Kjo masë synon të

themeloj agjencinë e punësimit dhe ngritjen e kapaciteteve të saja për planifikim dhe zbatimin e monitorimit më efektiv të masave aktive të tregut të punës dhe përfshirjes sociale, ulja e varfërisë me mundësitë e barabarta, e ka masën e përmirësimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, ku element kyç i kësaj mase është krijimi i Fondit të sigurimeve shëndetësore. Këto janë njëzet masat e përzgjedhura deri më tani në këtë proces, të cilat janë të identifikuara dhe të përshkruara në detaje, në kuadër të dokumentit të cilin ua kemi dërguar dhe të cilin e kemi përpara.

Muhamet Mustafa, kryetar, i falënderoi përfaqësuesit e Qeverisë për prezantimin e konceptit të dokumentit të programit të Kosovës për reformat ekonomike. Për fushën e menaxhimit të financave publike të masat e prokurimit publik, tha se kemi një avancim më të madh por që këtu duhet të ketë vëmendje më të madhe sidomos të projekteve për shuma të mëdha. Te zhvillimet sektoriale, Mustafa tha se duhet të merren masat indirekte të aftësia konkurruese, po ashtu, kemi një mbrojtje më të lehtë për prodhuesit vendorë, deri në atë masë sa që nuk e rrezikon konkurrencën e lirë fjala vjen te industria e qumështit, ne duhet ta kemi një stimulim për rritjen e ofertës vendore. Prandaj, Kosovës i nevojiten disa politika sektoriale për reforma strukturore dhe për disa sektorë kërkohet nevoja e rritjes së efikasitetit, qoftë të kuadrove edhe me mjete buxhetore. Ai potencoi një problem që po paraqitet në vazhdimësi, siç është mungesa e dhënave statistikore. Këtu, tha Mustafa, kemi mungesë të të dhënave statistikore në shumë sektorë për periudha që ndryshojnë kohë pas kohe, mospublikimi i numrit të papunëve, andaj këtu Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i duhet një forcim i kapaciteteve, sepse është një mungesë serioze mospërpunimi i shumë të dhënave statistikore.

Blerim Grainca pasi i përgëzoi përfaqësuesit e Qeverisë për prezantimin e draftit të programit të Kosovës për reforma ekonomike për vitin 2017-2019, tha se lidhur me fushat parësore, ku duhet të ndërmerren masat konkrete për të gjitha sektorët që janë ngritur, së pari duhet një reformë e madhe në harmonizimin e legjisllacionit. Pasi që janë listuar sektor për sektor, masat që duhet të ndërmerren, atëherë për sektorin e bujqësisë, përkundër subvencioneve të shumta pati deri më tani, edhe më tej kemi një bilanc negativ, sepse subvencionet dhe grantet nuk kanë shkuar në destinimin e caktuar, prandaj, për këtë sektor propozoj që të shkohet tani e tutje në investimet e projekteve dhe ngritjes së kapaciteteve në sistemin ujitjes së tokave. Sa i përket energjisë alternative, që duhet jetë 25-30% , këtu duhet të rriten masat e bashkëpunimit me Shqipërinë, pasi që siç dihet tani është ndërtuar linja e këmbimit të energjisë me Shqipërinë. Fusha e arsimit është shqetësuese, kur i kemi 40% të mësimitdhënëseve të papërgatitur profesionalisht për fusha të caktuara, prandaj, edhe këtu duhet të merren masat në profilizimin e shkollave dhe të hapën drejtime të profesioneve të caktuara, që mund të jenë të përgatitur për tregun punës.

Raif Qela tha se Programi i Kosovës për Reforma Ekonomike, i ofruar nga Qeveria duket se i ka përmbledhur çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me të ardhmen e zhvillimit ekonomik të vendit, sado që mund të ketë edhe nevojë për plotësime aty-këtu. Njëra prej atyre plotësimeve ashtu siç e theksoi edhe kryetari i komisionit, mendoj se është përmirësimi i statistikave në Kosovë, ngase është e pamundur të të analizohen rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit ekonomik, përderisa nuk kemi statistika të qëndrueshme dhe të besueshme. Nga çështjet e trajtuara, mendoj se për nga rëndësia, ndër kryesoret të masave të mjedisit të të bërit biznes, ashtu siç kemi theksuar edhe ju, është edhe rritja e efikasitetit gjyqësor përmes uljeve të

rasteve të grumbulluara. Kjo çështje po e pengon zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik, edhe pse kontestet në përgjithësi, kontestet pronësore, kontestet biznesore pengojnë shumë investimet, po e mbyllin derën e investimeve të jashtme, por edhe të brendshme. Te masat e reformës për shtrirjen e infrastrukturës përkatëse të rrjeteve të TIK-ut e keni theksuar se pritni nga Banka Botërore se do të investohet një kredi rreth 9 milion euro, për të cilën pritet të negociohet diku nga mesi i vitit 2017. Do të kisha dashur të dija se në cilat prej fushave mund të investohet në infrastrukturë brezëgjere apo në zhvillim të resurseve njerëzore sepse bindja ime është se ne qëndrojmë më mirë sesa të tjerët në infrastrukturë brezëgjere, aty diku jemi në rajon, ndërsa investimi në resurse njerëzore në ekonominë digjitale mendoj se mund ti sjell Kosovës shumë përparime, për arsyen se kemi mjaft kuadro të forta në fushën e programimit dhe në fusha të përafërta të teknologjisë të informacionit dhe ato kuadro në mungesë të organizimit të brendshëm, në mungesë të investimeve në këtë fushë brenda, po ikin pjesa më e madhe jashtë, siç janë programuesit. Kam vërejtje në mënyrën se si po hartohen në përgjithësi dokumentet të cilat po dalin nga institucionet më të larta shtetërore, mbase versioni në anglisht është mirë, por versioni në shqip ka pjesë të cilat nuk tingëllojnë hiq shqip, përkthimin me “google translate” mbase autori e ka shkruar atë në anglisht, e ka pas më lehtë se ndoshta edhe ka qenë në studime jashtë edhe e njëj gjuhën angleze mirë, por ka aq shprehje të paqarta, aq shprehje të pakuptimta në formulime sa që mund t’ua lexoj disa p.sh. ne serbo-kroatisht është më mirë sesa në shqip, ndonjërin prej tyre është boshllëku i aftësive në arsimin profesional ndërsa në serbisht është “ne dostasno”, me fjalë të tjera, në shqip është fjala më jo adekuate se në serbo-kroatisht. Ju lus që përpara se ta vëni këtë se ky është projekt nuk është akoma publik edhe si të tillë korrigjoheni para se ta bëni publik.

Duda Balje, pyeti se a ka mjete financiare për zbatimin e këtyre planeve? Në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, ku jam kryetare, shpesh kemi kërkesa nga ministritë e linjës që nuk kanë njerëz për t’i kryer gjitha këto punë, këtu po bëhet fjalë për shumë programe, a keni njerëz dhe mjete financiare për gjitha këto planë që duhet të zbatohen nga 5 ministritë e linjave të caktuara?

Sala Berisha- Shala, pas diskutimit të shumë çështjeve të Programit për reforma ekonomike 2017- 2019, tha se ajo çka po shoh unë, nuk është përfshirë sektori i minierave dhe mineraleve. Kjo fushë disponon me mjaftë resurse për zhvillimin ekonomik, andaj duhet të përfshihet në Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike 2017-2019. Faqja 6, te sektori i bujqësisë, cilat do të jenë prioritete? Te masa 8, zhvillimi i produkteve turistike në rajonet turistike të Kosovës, çka keni ndërmarrë deri më tani dhe si do ta zhvilloni sektorin e turizmit? Prandaj, për gjitha këto programe të reformave ekonomike, duhet të harmonizohet infrastruktura ligjore sepse mund të na paraqiten pengesat ligjore gjatë zbatimit në praktik.

Rrustem Berisha tha se për fushën e arsimit, së pari na nevojitet ta kemi një strategji, pra duhet të fokusohemi në aspektin ngritjes profesionale në bazë të kërkesave që i kërkon tregu i punës, të kemi shkolla dhe degë profesionale, sepse siç e dini, deri më tani kemi pas vetëm drejtim të përgjithshëm në disa lami edhe në universitete, siç janë fakulteti juridik dhe ekonomik, ku kemi mjaftë të diplomuar e që nuk kanë mundësi për gjetur punë. Tek zhvillimet sektoriale, investimet duhet të behën në bujqësi e posaçërisht në infrastrukturën e sistemit të ujitjes së tokave bujqësore, pasi për shumë toka bujqësore të privatizuara ose nuk kanë pas sistem të ujitjes ose edhe në disa raste janë dëmtuar, prandaj këto duhet të jenë me prioritet. Tek mjedis

biznesor kemi zvogëlim të investimeve të huaja, andaj, edhe këtu duhet të ndërmerren masat duhura. Për kontestet biznesore, duhet të kemi propozime konkrete në rritjen numrit të gjyqtarëve, në mënyrë që të jenë më efikas në shqyrtimin lëndëve që kanë të bëjnë me konteste biznesore. Tek marrëveshjet tregtare me shtetet fqinje, prodhuesit vendorë po kanë pengesa të shumta, prandaj, ne duhet t'i favorizojmë prodhuesit vendorë.

Enver Hoti theksoi se tek fushat që ju keni dhënë prioritet nëpër sektorë, vërejtja që nuk keni ndonjë masë të caktuar për fushën e turizmit. Pse keni menduar ta përfshini në Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike 2017-2019? Për fushën e arsimit ka kaluar kohë e gjatë, duke i aplikuar kurrikulat e shumta, ndërsa tani si do t'i qaseni reformave në arsim?

Avdullah Hoti, ministër i Ministrisë së Financave, sqaroi sa i përket këtyre masave që janë nxjerrë, shumë nga këto, nuk kanë implikime buxhetore, pasi që i kemi analizuar mirë deri në detaje se si të veprohet me reformat strukturore dhe nuk do të jetë problem buxheti për t'u zbatuar Programi i Kosovës për Reforma Ekonomike dhe se ne si Qeveri do të marrim parasysh të gjitha propozimet e Komisionit dhe do të inkorporojmë në përputhje me politikën që i kemi paraparë.

Pas debatit, Komisioni, nxori këtë:

Përfundim

Mbështetet me propozime Programi i Kosovës për Reforma Ekonomike 2017-2019.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se Rekomandimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit të Postës së Kosovës me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Komunitet, në bazë të këshillës ligjore të Departamentit ligjor të Kuvendit, duhet të zgjidhet në rrugë gjyqësore. Ndërsa, sa i përket zbatimit të Ligjit për Trepçën, do të kërkojmë informatë më shkrim nga ministria përkatëse. Në fund, ai e njoftoi Komisionin për tërheqjen e Projektligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme në Kosovë, nga ana e Qeverisë.

Mbledhja përfundoj në ora 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa